

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi XI - Nr. 9 / 2019 ... drejtësi për të gjithë



20 VJET
54 GJENERATA



KOMENT I KRYEREDAKTORIT



Baki KELANI

Policia e Kosovës (PK), përmes realizimit të objektivave strategjike dhe planeve zhvillimore, po vazhdon rrugëtimin e saj drejt përbushjes së detyrave dhe obligimeve karshi vendit dhe qytetarëve.

Edhe përkundër shumë sfidave dhe vështirësive që ka kaluar PK-ja ndër vite, me përkushtimin dhe angazhimin në punë, me rezultatet e arritura në fusha të ndryshme, po dëshmon avancimin dhe ngritjen profesionale të zyrtarëve policorë.

Puna e palodhshme, kontributi dhe sakrifica e secilit pjesëtar të PK-së për gati 20 vjet vlerësohet dhe çmohet shumë lart, andaj për t'u përbushur çdo herë me sukses misioni dhe vizioni i PK-së, menaxhmenti policor kujdeset në vazhdimësi për përkrahjen, mbështetjen dhe avancimin e mëtejme me trajnime mandatore, trajnime të specializuara dhe ngritjen në karrierë të zyrtarëve policorë.

Ndërtimi dhe zhvillimi i Policisë së Kosovës, është një proces që nuk ndalet asnjëherë dhe pjesë e këtij procesi është edhe ristrukturimi i strukturës organizative të PK-së dhe zhvillimi në karrierë i zyrtarëve policorë.

Përmes promovimit të zyrtarëve në grada përbushen jo veçse objektivat e organizatës dhe struktura e saj organizative, por edhe objektivat e vetë zyrtarëve policorë, sepse kjo është edhe një mundësi e zhvillimit individual të tyre.

Pa dyshim, lidërsi ka një rol të rëndësishëm brenda një organizate dhe shpesh është komponent kyç në përcaktimin e suksesit të një shërbimi, si dhe çdo pozicion apo gradë brenda institucionit policor ka rëndësinë e vet në suksesin e organizatës.

Bazuar në nevojat operacionale të PK-së, si dhe bazuar në ristrukturimin e strukturës organizative, është vlerësuar i nevojshëm fillimi i procedurës së gradimit edhe për grada të larta, përfshirë gradën e kolonelit, për të cilën nuk kishte pasur gradime që nga viti 2016.

Policia e Kosovës, tani në prill të vitit 2019, përmes një procesi të gjatë që i ka paraprirë ristrukturimit dhe procesit të gradimit, në një ceremoni zyrtare gradoi disa zyrtarë policorë në gradat kolonel, nënkolonel, major dhe kapiten.

PK-ja pritet që në vazhdimësi konform planifikimeve të saja strategjike, të zhvillohet si institucion, të ngritë integritetin dhe performancën policore, përfshirë edhe avancimet e zyrtarëve të saj policorë, në mënyrë që të vazhdohet trendi si institucioni më i besueshëm dhe transparent në vend.



Revistë e Policisë së Kosovës

Botues:
ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:
Baki KELANI

Redaktor:
Daut HOXHA

Tel.: 038 5080 1243
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 506 308
Mob.: 044 181 418

E-mail:
baki.kelani@kosovopolice.com
daut.hoxha@kosovopolice.com
zimp@kosovopolice.com

Bashkëpunëtorë:
Dr. Lindita KAJTAZI
Merita CANOLLI - GASHI
Arlinda REXHEPI- GËRXXHALIU
Osman OSMANI
Begishe KRASNIQI

Dizajni:
Çajup KAJTAZI

Lektor:
Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Fotograf:
Arbër MUHADRI

Telefon: 192
info@kosovopolice.com
www.kosovopolice.com
facebook.com/KosovoPolice
twitter.com/Kosovo_Police



PËRMBAJTJA

KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Z.RAMUSH HARADINAJ, VIZITON POLICINË E KOSOVËS, 4

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PK-SË GJATË VIZITËS NË VERI TË MITROVICËS KËRKON PËRMBUSHJE TË DETYRAVE DHE OBLIGIMEVE POLICORE KARSHI QYTETARËVE PA DALLIM, 4

JAMES P. O'NEILL KOMISAR I POLICISË SË NEW YORKUT DHE RASHIT QALAJ, DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI, E PARA NË BALLKAN, 5

QENDRA E THIRRJEVE, GJITHNJË E GATSHME TË PRANOJË THIRRJE EMERGJENTE, 6-7

ZYRTARË TË POLICISË SË KOSOVËS TRAJNOHEN NGA BYROJA FEDERALE E HETIMEVE E SHBA-SË (FBI), 8-9

POLICIA GRADON NË GRADA TË LARTA 136 ZYRTARË, 10

POLICIA E KOSOVËS ME DISA AKTIVITETE NË SHËNIMIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË TOKËS, 11

PËRDORIMI I ALKOOLIT GJATË VOZITJES PARAQET RREZIK SERIOZ, 11

IZET DEMAJ, HEROI MË I RI I KOSOVËS, 12-13

DIZAJNERI I POLICISË SË KOSOVËS QË IU JEP JETË KREATIVE AKTIVITETEVE POLICORE, 14-15

NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE (AKSP) VAZHDON TRAJNIMIN GJENERATA E 54-TË E KADETËVE POLICORË, 16-18

PËRPEKJET E POLICISË SË KOSOVËS KUNDËR PËRDORIMIT DHE TRAFIKIMIT TË DROGAVE MBETEN INTENSIVE DHE JAPIN REZULTATE, 19

UEB FAQJA ZYRTARE E POLICISË SË KOSOVËS WWW.KOSOVOPOLICE.COM, 20-21

INICIATIVA POZITIVE PËR PËRFSHIRJE MË AKTIVE TË GJINISË LIDHUR ME SIGURINË NË SHOQËRI, 22

NJËSIA PËR SIGURIMIN E OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE FETARE, 23

FUSHATA HUMANITARE "DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT", 24-25

KURIOZITETE, 26-27

FOTOLAJM, 28

MË GJERËSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.



Kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Ramush Haradinaj, viziton Policinë e Kosovës

Gjatë majit të këtij viti, Policinë e Kosovës e ka vizituar kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Ramush Haradinaj, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme rreth sigurisë së përgjithshme në vend dhe mirëqenies së zyrtarëve policorë.

Kryeministri Haradinaj ishte i shoqëruar edhe nga ministri i Financave z.Bedri Hamza dhe ministri i Punëve të Brendshme z. Ekrem Mustafa, të cilët janë pritur në takim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj me bashkëpunëtorë.

Në takimin i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, z. Qalaj fillimisht falënderoi kryeministrin z. Haradinaj për vizitën e tij dhe njëkohësisht përmes një prezantimi njoftoi të pranishmit mbi angazhimet, aktivitetet dhe realizimin e objektivave të Policisë së Kosovës, të cilat kanë treguar rezultate pozitive në fusha të ndryshme përgjatë kësaj periudhe kohore të këtij viti.

Policia e Kosovës vazhdon të mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të saja ligjore, në funksion të zbatimit të ligjit, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike në vend.

Ndërsa kryeministri Haradinaj ka falënderuar drejtorin Qalaj dhe të gjithë policët e Kosovës për punën që e bëjnë në sigurimin e qytetarëve dhe pronës së tyre, duke vlerësuar se PK-ja është një ndër institucionet që e bart përgjegjësinë kryesore, për të zbatuar ligjin, për të zbatuar rendin dhe sigurinë publike.

Andaj, Qeveria e Kosovës do të kujdeset që të përkrahë Policinë e Kosovës në fusha të ndryshme, përfshirë edhe në pajisjet e nevojshme logjistike, të cilat ju shërbejnë si mjet i punës në realizim të detyrave në mënyrë sa më efektive.

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së gjatë vizitës në Veri të Mitrovicës kërkon përmbushje të detyrave dhe obligimeve policore karshi qytetarëve pa dallim

Qëllimi i kësaj vizite të drejtorit Qalaj ishte ngritja e performancës dhe integritetit policor në punë, ndërmarrja e masave policore në aspektin reagues dhe parandalues të veprave të ndryshme kriminale.

Drejtori Qalaj ndër të tjera ngriti edhe çështjet kyçe që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarit, bashkëpunimin dhe takimet me komunitetin, sigurinë në trafik, parandalimin e veprave kriminale, si grabitjet, vjedhjet, drogat etj.

Nga stafi udhëheqës i Drejtorisë Rajonale në Veri të Mitrovicës u kërkua që të punohet dhe të angazhohen edhe më shumë, në mënyrë që të krijohet një klimë e qetë dhe më e sigurt për qytetarët, e që kontribuon edhe në sigurinë e përgjithshme të vendit.

Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur që të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar, kontrabandës si dhe të parandalojë rastet kriminale, andaj kërkohet angazhim nga të gjithë punonjësit pa dallime.

Takimi rezultoi me zotimin për angazhime shtesë drejt përmbushjes së detyrave dhe obligimeve policore karshi qytetarëve të vendit.



James P. O'Neill komisar i Policisë së New Yorkut dhe Rashit Qalaj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, me marrëveshje bashkëpunimi, e para në Ballkan



Në fillim të qershorit të 2019-tës, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Rashit Qalaj, i shoqëruar nga stafi i tij, në këtë rast drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore znj. Taibe Canolli, drejtori i Divizionit Kundër Krimin të Organizuar znj. Florie Hajra dhe zyrtari

nga ICITAP-i amerikan z. Richard Staples, kanë realizuar një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kanë zhvilluar takim me komisarin e Policisë së New Yorkut z. James P. O'Neill, si dhe kanë realizuar vizita në Akademinë Policore, departamente të

ndryshme, Homeland Security (Doganë dhe Polici Kufitare), në muzeun memorial etj.

Vizita disa ditore vlerësohet e një rëndësie të veçantë dhe kishte për qëllim vazhdimin e avancimit të bashkëpunimit ndërpoligor ndërmjet dy vendeve, si dhe intensifikimin e marrëdhënieve policore me interes të përbashkët.

Si rezultat i takimeve zyrtare dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, me 07.06.2019, nga drejtori Qalaj dhe komisar O'Neill u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi, i cili vlerësohet si i pari me vendet e Ballkanit.

Përmes nënshkrimit të këtij memorandum synohet vendosja e bashkëpunimit sa më cilësor, në shkëmbimin e informacioneve policore, në luftën kundër krimin të organizuar, krimin trans-kufitar, parandalimin e kriminalitetit, veçanërisht në format komplekse të krimin të organizuar, krimin me elemente ndërkombëtare si dhe veprave tjera penale, përfshirë edhe shkëmbimin e praktikave më të mira policore.

Me rastin e nënshkrimit të këtij memorandum të dy vendet vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyeshme të të dy policive në të gjitha fushat policore si dhe nevojën e avancimit të bashkëpunimit të mëtejshëm edhe në të ardhmen.





QENDRA E THIRRJEVE, GJITHNJË E GATSHME TË PRANOJË THIRRJE EMERGJENTE

Qendra operative rajonale - Alfa Kontroll është qendër komunikimi për pranimin e thirrjeve dhe shpërndarjen - delegimin e të gjitha informacioneve, të cilat vijnë nga qytetarët adresuar në Polici

Qendra operative rajonale - Alfa Kontroll është qendër komunikimi për pranimin e thirrjeve dhe shpërndarjen - delegimin e të gjitha informacioneve, të cilat vijnë nga qytetarët adresuar në Polici. Në Alfa Kontroll pranohen të gjitha thirrjet që bëhen nga numrat e telefonisë mobile në linjën emergjente '192', gjithashtu edhe

nga telefonatat që bëhen nga numrat fiks të cilat vijnë nga rajonet tjera, në rajonin e Prishtinës.

Të gjitha informacionet e pranuar fillimisht evidentohen nga operatorët të cilët punojnë në këtë qendër, e më pas analizohen për të kuptuar natyrën e rastit, ankesës apo kërkesës të cilën e ka paraqitur thirrësi. Të

njëjtat informacione më pas i delegohen stacionit policor apo njësisë përkatëse për veprimet e mëtutjeshme. Qendra operative rajonale shërben si qendër komunikimi dhe koordinimi në mes të dhomës komanduese dhe njësisë policore në terren për menaxhimin e planeve operative dhe situatave të ndryshme të cilat paraqiten.

Kjo qendër të gjitha informacionet, raportet e shpejta, personelin në detyrë, fuqinë punëtore dhe raportet e situatës ditore 24 orëshe të cilat i pranon nga stacionet dhe njësitë e rajonit të Prishtinës, i kontrollon dhe i përcjell në Qendrën Komanduese në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Me kërkesën e njërive në terren në këtë qendër bëhet po ashtu edhe verifikimi i veturave, personave si dhe kërkesave tjera të cilat vijjnë nga terreni. Në qendrën e thirrjeve punojnë zyrtarë të cilët janë të ndarë në ekipe gjatë 24 orëve/7 ditë.

Zyrtarët e qendrës rajonale operative i karakterizon aftësia në komunikim, të qenit i qetë dhe i aftë të punojë nën presion. Po ashtu zyrtarët e qendrës së thirrjeve duhet të kenë njohuri për punën e përgjithshme policore si dhe për punën e agjencive të tjera jashtë Policisë, pasi që shumë herë pranohen informacione të ndryshme dhe pjesëtari i Policisë duhet ta adresojë atë informacion tek njësitë përkatëse për veprime. Në qendrën operative rajonale pranohen informacione të llojeve të ndryshme, të cilat ndryshojnë varësisht nga koha e thirrjes, sezonit, si dhe dukurive të cilat ndodhin në terren. Vlen të veçohet zezoni veror, ku mbrëmjeve pranohen ankesa të shumta lidhur me prishjen e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet në të cilat performohet muzikë. Por përveç tyre ka thirrje të shumta për parkime të parregullta, aksidente në trafik, raste të vjedhjeve, dëmtimeve në pronë etj.

Qendra operative rajonale gjatë një viti (2018) ka pranuar gjithsej 293.288 thirrje që do të thotë brenda 24 orëve ka pranuar afërsisht mbi 800 thirrje, të cilat janë përcjellë tek njësitë dhe stacionet kompetente për trajtimin e informatës.

Rrugët e pranimit të informatave/thirrjeve bëhen përmes linjës emergjente 192, nga telefonua fikse, si dhe përmes radiolidhjes, por përveç këtyre tashmë është duke u testuar dhe pritet implementimi i sistemit të ri 3D – 'GIS' me anë të të cilit qytetarët mund të dërgojnë mesazhe përmes të cilave Policia mund ta lokalizojë lokacionin nga i cili vjen mesazhi.

Informacionet e pranuar evidentohen nga zyrtarët kompetentë e më pas përcillen tek

stacioni apo edhe tek njësia përkatëse, e cila më pas pasi të arrijë në vendngjarje raporton se për çfarë rasti bëhet fjalë dhe se çfarë hapash duhet të ndërmerren. E më pas duke iu referuar përshkrimit të rastit nga njësia vlerësojmë nëse duhet të njoftohen ndihma e shpejtë, zjarrfikësit, inspeksioni, FSK-ja, KFOR-i, apo edhe EULEX-i, në mënyrë që të realizohet detyra e Policisë me sukses.

Për të gjitha veprimet përpilohet raport me shkrim nga i cili njoftohet qendra operative rajonale, e më pas varësisht nga natyra e rastit informacionet barten edhe tek qendra komanduese në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Mënyra e pranimit të informacionit është hap kyç në trajtimin e rastit, andaj zyrtarët punonjës në qendrën operative rajonale duhet të marrin sa më shumë informata rreth rastit, duke bërë pyetjet si: Çka ka ndodhur? Ku ka ndodhur? si dhe në raste të jashtëzakonshme atëherë kur kemi të bëjmë me raste të rënda kërkohet që telefonuesi të qëndrojë në linjë, në mënyrë që gjatë tërë kohës të merren informacione shtesë derisa në lokacion të arrijë njësi policore.

Operatorët që punojnë në qendrën operative rajonale, edhe përkundër thirrjeve të shumta, ngarkesës në punë si dhe presioneve kohore, në të shumtën e rasteve arrijnë që t'iu dalin në ndihmë qytetarëve të cilët kërkojnë ndihmën policore, apo edhe ndihmën e institucioneve dhe agjencive të tjera, të cilat nuk reagojnë derisa të kërkohej Policia. Falë profesionalizimit dhe angazhimit të tyre, stafi ka arritur që pas pranimit të informacioneve për persona të ndryshëm të dyshuar, të cilët kanë kryer akte të ndryshme kriminale kanë koordinuar veprimet e njërive të ndryshme në terren dhe kanë arritur që personat të arrestohen. Por përveç rasteve të veprave penale dhe kundërvajtjeve ne si Polici u jemi përgjigjur thirrjeve të natyrave të ndryshme, ku si një nga rastet më specifike të cilin e kemi pranuar ka qenë rasti i një fëmije 7 vjeçar në rrezik për t'u ngulfatur, me ç'rast Policia ka vepruar duke shkuar në vendngjarje dhe përmes ndihmës së parë të ofruar nga zyrtarët policorë fëmijës i është

shpëtuar jeta.

Numri i thirrjeve në qendrat operative rajonale është i ndryshëm, varësisht numrit të popullsisë, numrit të komunave që ka rajoni i caktuar dhe shumë faktorëve të tjerë. Prandaj, në vijim është bërë një përmbledhje e numrit të thirrjeve të qendrave rajonale të rajoneve të ndryshme.

Në Prishtinë numri i thirrjeve brenda 24 orëve është rreth 803 thirrje

Në Ferizaj numri i thirrjeve brenda 24 orëve është rreth 200 thirrje.

Në Gjakovë brenda 24 orëve pranohen afërsisht 90-95 thirrje.



Në Gjilan numri i thirrjeve brenda 24 orëve është rreth 80 thirrje.

Në Pejë qendra e thirrjeve brenda 24 orëve pranon afërsisht 38 thirrje.

Në Prizren qendra e thirrjeve brenda 24 orëve pranon rreth 250 thirrje.

Në Mitrovicë numri i thirrjeve brenda 24 orëve është rreth 150-170 thirrje.

Mitrovicë veri numri i thirrjeve brenda 24 orëve është afërsisht 13-18 thirrje.

Duke u bazuar në këto shifra që paraqitëm, marrë në total, numri i thirrjeve në qendrat operative në të gjitha rajonet e Kosovës arrin shifrën rreth 1660 thirrje brenda një dite (24 orë).

Kjo qendër ka rol thelbësor në Polici duke bërë që përkushtimi në punë ka arritur që rastet e ndryshme të paraqitura të adresohen sipas nevojës dhe të trajtohen me kohë.

Arlinda REXHEPI- GËRXXHALIU

ZYRTARË TË POLICISË SË KOSOVËS TRAJNOHEN NGA BYROJA FEDERALE E HETIMEVE E SHBA-së (FBI)

Policia e Kosovës si forcë kryesore e zbatimit të ligjit në vend, në vazhdimësi ka bashkëpunuar me shtete të ndryshme dhe agjenci profesionale për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve policorë.



Policia e Kosovës si forcë kryesore e zbatimit të ligjit në vend, në vazhdimësi ka bashkëpunuar me shtete të ndryshme dhe agjenci profesionale për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve policorë.

Aktivitetet dhe angazhimet e rëndësishme ku përfshihen edhe trajnime të niveleve të ndryshme, duke filluar nga ato elementare e deri te trajnimet më të avancuara kanë qenë dhe mbeten prioritet i planifikimeve

profesionale të Policisë së Kosovës.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi prioritet ka qenë intensifikimi i aktiviteteve mbështetëse mjaft të rëndësishme për PK-në nga partneri ynë ICITAP-i amerikan, ku me mbështetjen e tyre nga data 6 deri me 10 maj 2019, është realizuar kursi trajnues “Negocimi në Situata të Krizës” trajtim njëjavorë (40 orësh) nga FBI-ja, për 25 anëtarë të Policisë së Kosovës.

Nga këta pjesëmarrës që kanë ndjekur

këtë trajnim përfshihen zyrtarë nga njësi të ndryshme të Policisë së Kosovës, gjë që ka ofruar një mundësi të shkëlqyer për përfitim të praktikave të reja nga një agjenci me autoritet dhe profesionalizëm të lartë, siç është FBI-ja amerikane.

Si shtesë për menaxhmentin e lartë të Policisë së Kosovës dhe personelin ekzekutiv komandues është mbajtur edhe një ligjëratë në temën “Konceptet komanduese dhe vendimmarrja në



negociatat në situata të krizave”.

Pjesëmarrësit kanë kryer ushtrime klasore dhe në terren, të cilat janë realizuar nga ekipi i Byrosë Federale të Hetimeve (FBI) nga SHBA-ja.

Ky trajnim ka përfunduar me ceremoninë e diplomimit të pjesëmarrësve në të cilin drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe zyrtarë të lartë të ICITAP-it kanë dhënë fjalimet e tyre përmbyllëse.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. QALAJ ka falënderuar ICITAP-in për kontributin e madh dhe përkrahjen e vazhdueshme që po jep në mbështetjen e Policisë së Kosovës, në fusha të ndryshme përfshirë edhe trajnimet mjaft të nevojshme e profesionale nga ekspertë me renome siç ishin këta të fundit nga FBI-ja amerikane.

Zhvillimi i anës profesionale është gjithnjë i nevojshëm për ngritjen e cilësisë dhe trajnimet e këtij niveli janë të mirëseardhura dhe ndikojnë mirë në arritjen performancës së dëshiruar dhe sukseseve në punë.





Policia gradon në grada të larta 136 zyrtarë

Në prill të këtij viti, Policia e Kosovës, në kuadër të avancimeve të vazhdueshme dhe ngritjes profesionale si dhe strukturimit brenda organizatës, në një proces transparent, ka bërë avancimin në grada të larta të 136 zyrtarëve policorë.

Prej tyre 19 zyrtarë në gradën kolonel, 13 zyrtarë në gradën nënkolonel, 45 zyrtarë në gradën major dhe 59 zyrtarë në gradën kapiten.

Me këtë rast Policia organizoi edhe një ceremoni solemne në të cilën fjalë rasti mbajtën ministri i Punëve të

Brendshme z. Ekrem Mustafa, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj si dhe bashkëpunëtorë nga stafi ndërkombëtar që veprojnë në Kosovë.

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa tha se siguria e shtetit është siguri për familjet kosovare.

“Besueshmëria në Polici është një nga faktorët kryesorë që qytetari jonë e jep. Ndihej krenar që gjendem para jush por edhe i emocionuar që më është dhënë mundësia që të jem këtu në gradimin e zyrtarëve nga të gjitha rajonet. Siguria

e shtetit është siguria e familjeve tona, e qytetarëve tanë”, tha ndër të tjera ministri Mustafa.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj tha se sot gradohen ata të cilët punuan dhe u angazhuan për vite të tëra në shërbim të vendit dhe të qytetarëve.

“Së bashku me kolegët tanë, të mbajmë rend dhe ligj, të mbrojmë pronën, të mbrojmë kufirin shtetëror, të parandalojmë aksidentet e trafikut, t'i hetojmë veprat penale, e po ashtu t'i japim shpresë popullit të Kosovës dhe detyra kryesore e secilit prej nesh është detyrë patriotike që të mundësojmë gjithsecilin që të ndihet si në shtëpinë e tij. Kemi një detyrë fisnike dhe asnjëri nga ne nuk mund të bëjë shumë pa ndihmën e njëri-tjetrit dhe partnerit kryesor, popullit. Falënderoj Qeverinë për mbështetje. Kur Qeveria mbështet Policinë e Kosovës, ajo e mbështet edhe popullin e Kosovës”, tha Qalaj.

Me marrjen e gradave zyrtarët policorë morën edhe detyra dhe përgjegjësi të reja.

Kemi një detyrë fisnike dhe asnjëri nga ne nuk mund të bëjë shumë pa ndihmën e njëri-tjetrit dhe partnerit kryesor, popullit



Merita CANOLLI - GASHI



Policia e Kosovës me disa aktivitete në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës

Duke e ditur rëndësinë e të qenit i sigurt, të jetuarit shëndetshëm dhe frymuar lirshëm, në shenjë të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës edhe Policia dha kontributin e vet duke marrë pjesë në këtë shënim me një aktivitet simbolik.

Me rastin e shënimit të kësaj dite të planetit Tokë, Policia e Kosovës planifikoi disa aktivitete policore në shenjë të shënimit të kësaj dite në mënyrë simbolike, e cila vlerësohet si mjaft e rëndësishme për planetin Tokë dhe mbarë njerëzimin.

Këto aktivitete janë realizuar në disa rajone policore, ku përveç menaxhmentit të lartë të PK-së në krye me drejtorin e Përgjithshëm z. Rashit Qalaj, janë angazhuar edhe zyrtarë të profileve të ndryshme, përfshirë njësitet kufitare me barkë, të cilët kanë marrë pjesë në dhënie e kontributit të tyre te Liqeni i Badovcit.

Policia e Kosovës përveç këtyre aktiviteteve policore, ka qenë e angazhuar edhe në ofrimin e asistencës policore në aspektin e sigurisë, kryesisht ndaj të gjitha institucioneve, agjencive dhe organizatave të ndryshme, të cilat kanë realizuar aktivitete në shënimin e kësaj dite.

Duke e vlerësuar si një ditë mjaft të rëndësishme e cila shërben për të dhënë alarmin për dëmet që njerëzimi mund t'iu shkaktojë pyjeve, lumenjve, tokës dhe pasurive të tjera të natyrës, Policia e Kosovës duke u bërë “Mik i Tokës” do të vazhdojë të kontribuojë në ndërgjegjësimin për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së lartë të ajrit, ujit e tokës në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj date mbetet reflektimi në mbrojtjen fundamentale të planetit Tokë dhe të gjitha resurseve të saj nga ndotja dhe degradimi i saj, ku një rol të rëndësishëm ka edhe Policia e Kosovës, e cila do të vazhdojë të ndërmarrë veprime policore drejt parandalimit dhe bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante të kësaj natyre.

Dita Ndërkombëtare e Planetit Tokë duhet të na shërbejë të gjithëve si një vetëdijësim në mbrojtje të Tokës, andaj edhe Policia e Kosovës në vazhdimësi mbetet e angazhuar për mbrojtjen e tokës dhe resurseve të saj, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet kompetente dhe qytetarët, të cilët njëkohësisht i ftojme për një bashkëpunim edhe më të madh në këtë drejtim.

Ky aktivitet ishte atraktiv duke dalë komplet nga natyra e punëve të rënda policore dhe me këtë aktivitet Policia sensibilizohet me çdonjërin qytetar që ka për obligim ta mbajë pastër vendin ku merr frymë.

Përdorimi i alkoolit gjatë vozitjes paraqet rrezik serioz

Policia me angazhime dhe masa konkrete për parandalim të aksidenteve


Gjatë marsit të këtij viti Policia e Kosovës realizoi disa aktivitete për të parandaluar aksidentet në trafik.

Vozitja/drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit përfshin një nga rreziqet serioze për sigurinë në trafikun rrugor.

Humbja e jetëve njerëzore si pasojë e shkakut të aksidenteve nëpër rrugët tona edhe gjatë këtij fillim-viti ka qenë shqetësuese.

Policia e Kosovës vazhdon angazhimin e saj në realizimin e planeve konkrete policore, që kanë për qëllim ngritjen e vazhdueshme të sigurisë në trafikun rrugor si dhe uljen e aksidenteve.

Për këtë arsye masa aktive po ndërmerren në implementimin e planit operativ “Drejtimi i automjetit nën ndikim të alkoolit”, ku vetëm gjatë periudhës kohore (01-16.03.2019) nga njësitet policore janë shqiptuar 102 (njëqind e dy) tiketa ndaj kundërvajtësve që kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, si dhe janë iniciuar 2 (dy) raste/kallëzime penale.





IZET DEMAJ, HEROI MË I RI I KOSOVËS

Në dhjetor të 2018-ës në filialin e bankës së NLB-së në Istog, ka ndodhur një rast tentim grabitjeje e armatosur

Njësitet policore kanë ndërmarrë veprimet e menjëhershme policore për t'iu përgjigjur vendit të ngjarjes, ku me të arritur në atë lokacion kanë hasur në personin e dyshuar i cili posedonte një armë zjarri të gjatë, si dhe dyshohej që kishte marrë peng dy persona.

Personi i dyshuar në përpjekje për t'u larguar nga vendi i ngjarjes ka shtënë me armë zjarri drejt zyrtarëve policorë, të cilët në vetëmbrojtje të tyre dhe të qytetarëve janë detyruar t'i përgjigjen me armë zjarri duke e neutralizuar dhe duke e lënë të plagosur personin e dyshuar.

Gjatë intervenimit policor, si pasojë e shkëmbimit të armëve të zjarrit një zyrtar



policor është plagosur rëndë dhe i njëjti është dërguar për trajtim mjekësor në spitalin rajonal të Pejës.

Gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes, në afërsi është gjetur një granatë dore, një armë zjarri revole dhe një armë AK-47 me municion, të cilat i ka poseduar i dyshuari.

Disa orë më vonë nga mjekët kompetentë është konfirmuar vdekja e zyrtarit policor i cili ka shërbyer në stacionin policor në Istog, si dhe vdekja e personit të dyshuar nga fshati Shushicë e Ulët e Istogut.

Përkushtimi i Izet Demajt për mbrojtjen e qytetarëve është vlerësuar lart nga të gjithë drejtuesit e institucioneve të vendit



dhe nga qytetarët. Izet Demaj u shpall zyrtarisht “Hero i Kosovës”.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në nenin 84 (28) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit nr. 03/L-094 për presidentin e Republikës së Kosovës, gjithashtu në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-070 për Dhënien e Dekoratave dhe në Rregulloren (P) nr. 04/2016, për policin e rënë heroikisht në krye të detyrës dhe në mbrojtje të qytetarëve, Izet Demajn, ka ndarë urdhrin “Hero i Kosovës”.

Urdhri “Hero i Kosovës” u jepet personave që kanë bërë vepra trimërie dhe sakrifice, si dhe që kanë dëshmuar veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë lufte apo paqeje.

Vendimi, certifikata dhe urdhri “Hero i Kosovës” iu dorëzuan familjes Demaj.

Për shkak të rastit të nesërmen u shpall ditë zie në Kosovë.

Demaj u varros me nderime të larta shtetërore në Koshare, në varrezat e dëshmorëve të luftës së fundit në Kosovë. Policia e Kosovës me këtë ngjarje dëshmoi edhe një herë se mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të saja ligjore, me qëllim të ruajtjes së rendit

dhe sigurisë publike, ruajtjes së jetës dhe pronës si dhe parandalimin dhe arrestimin e kryerësve të veprave penale.

Vlen të theksohet se që prej themelimit të

Policiisë në Kosovë i kemi 20 policë të rënë në detyrë dhe se Policia vlerësohet si njëri ndër institucionet me besueshmërinë më të lartë nga qytetarët e vendit.



DIZAJNERI I POLICISË SË KOSOVËS QË IU JEP JETË KREATIVE AKTIVITETEVE POLICORE

Krahas punëve operacionale të Policisë së Kosovës që organizohen çdo ditë, në polici kryhen edhe punë kreative të cilat e mëvetësojnë aktivitetin policor në mënyrë profesionale e të përkryer

Çajup Kajtazi u lind në fshatin Tërrnovë të Skenderajt. Shkollimin fillor e ndoqi në shkollën “Migjeni” ndërsa shkollën e mesme e përfundoi në shkollën e mjekësisë “Xheladin Dedaj” në Mitrovicë në degën e infermierisë së përgjithshme. Ka studiuar në Shkencat Politike – në drejtimin “Administratë Publike”.

Çajupi përveç shkollimit adekuat të cilin e ka përfunduar me sukses, është certifikuar edhe në disa programe të ndryshme si: ‘Macromedia Flesh dhe Dreamweaver’, ‘Dizajn grafik –web’, gjithashtu ka kryer disa trajnime jashtë vendit si ‘NETWORK Administration training’ në Turqi, dhe në Akademinë Policore për Siguri Publike në Vushtrri: “Trajnim për Fotografim Forenzikë” etj.

Ndërsa në fushën e mjekësisë është shpërblyer me disa mirënjohje dhe është pajisur me disa certifikata. Ka marrë pjesë në një punëtori për këshilltar psikosocial, është i certifikuar për të ligjëruar për sëmundjet infektive si “HIV-AIDS, Hepatiti dhe IST”, ka marrë certifikatë nga UNMIK-u për ligjërimin rreth “HIV-AIDS-it, STI Peer Education Training”, ka marrë pjesë në konferencën e dytë ndërkombëtare të infermierisë në Kosovë “2nd International Nursing Conference in Kosovo”, si dhe ka ndjekur disa



E si detyrë më madhore që i kishte rënë në përgjegjësi dizajnerit të policisë ishte edhe ridizajnimi i uniformës zyrtare për zyrtarët policorë. Në fillim të vitit 2011, kur Policia e Kosovës, merr vendim nga drejtori i PK-së të ridizajnojë uniformën e Policisë, caktohet grupi punues, në të cilin caktohet si anëtar aktiv edhe dizajneri Kajtazi dhe si bashkëpunim i grupit u vendos ndryshimi i uniformës moderne krahas uniformave të policive të ndryshme rajonale

praktika mujore nga lëmi i “Urgjencës mjekësore”.

Si shenjë për punë të mirë ai ka pranuar edhe disa mirënjohje për punët policore që ndërlidhen me fushën e dizajnit grafik nga: ‘ICITAP-i amerikan’ (për bashkëpunim të shkëlqyer), një tjetër nga Instituti i Kosovës Kundër Krimeve Ekonomike, një nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor, nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Renda (DHKR), po ashtu nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë

(DPBP) si dhe nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP).

Krahas punëve operacionale të Policisë së Kosovës që organizohen çdo ditë, në Polici kryhen edhe punë kreative të cilat e mëvetësojnë aktivitetin policor në mënyrë profesionale e të përkryer.

Punën e dizajnit grafik në organizatën tonë e kryen zyrtari Çajup Kajtazi i cili është punësuar në Polici që nga viti 2005, fillimisht si infermier i përgjithshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore, ndërsa nga viti 2007 merr pozitë të re si producent ekzekutiv dhe pastaj si webdizajner në kuadër të Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) ku vazhdon të jetë edhe sot.

Nga viti 2007, kur është pavarësuar Policia e Kosovës nga kompetencat e UNMIK-ut,



janë bartur të gjitha përgjegjësitë të zyrës dhe dizajnit grafik në PK, duke bërë që nga kjo zyrë të mirëmbahen dhe të plotësohen me informacione webfaqja, intraneti, revista zyrtare 'Mbrotësi' si dhe të gjitha dizajnimet e herëpashershme nga drejtori e divizione të ndryshme policore.

Zyra e dizajnit grafik qysh në fillim të marrjeve të përgjegjësive ka arritur të kryej shumë punë me bazë disajnimin që ndërliken më punën policore të PK-së.

Si aktivitete dhe punë të zakonshme që bëhen në kuadër të kësaj zyreje janë dizajnimet e raporteve strategjike të Policisë së Kosovës, raportit vjetor i PK-së, broshurave promovuese të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore, broshurave për sigurinë e komunikacionit rrugor, broshurat vetëdijësuese, revistën zyrtare të PK-së, kalendarin vjetor, ftesat, si dhe të gjitha dokumentet policore që ndërliken më fushën e dizajnit grafik që dalin nga Policia e Kosovës.

E si detyrë më madhore që i kishte rënë në përgjegjësi dizajnerit të policisë ishte edhe

ridizajnimi i uniformës zyrtare për zyrtarët policorë. Në fillim të vitit 2011, kur Policia e Kosovës, merr vendim nga drejtori i PK-së të ridizajnojë uniformën e Policisë, caktohet grupi punues, në të cilin caktohet si anëtar aktiv edhe dizajneri Kajtazi dhe si bashkëpunim i grupit u vendos ndryshimi i uniformës moderne krahas uniformave të policive të ndryshme rajonale.

Kreativiteti nuk mungon në këtë zyrë, kur dihet se çdo kërkesë që vjen çoftë nga zyra e drejtorit apo drejtorive të ndryshme policore, organizohet në bashkëpunim me palën kërkuese dhe bëhet dizajnimi i projektit të kërkuar dhe gjithashtu bëhet gati deri në printim.

Krahas bashkëpunimeve në kuadër të dizajnit, nuk mungon as bashkëpunimi me organizatat e ndryshme ndërkombëtare me vendqëndrim në Kosovë, siç janë OSBE-ja, ICITAP-i etj.

Ndër bashkëpunimet e tjera vlen të theksohet se kjo zyrë zinxhir bashkëpunimi mban edhe me institucionet qeveritare, si me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe

Inspektoratin Policor të Kosovës.

Shprehia e punës për dizajnerin e PK-së, z. Çajup Kajtazi, është shumë specifike dhe kërkon imagjinatë të thekshme, qetësi dominuese dhe modesti në punë. Ai mban përgjegjësi dhe gjithmonë është efikas dhe i shpejtë në detyrat që i parashirohen. E si rrjedhojë e asaj që përmendëm, jashtë detyrave zyrtare që ngarkohet në PK z. Kajtazi është edhe autor i enigmatikës ku edhe formulon disa revista me fjalëkryqe dhe është dizajner i qindrave projekteve të ndryshme, si libra, gazeta, revista që e plotëson personalitetin e tij prej një artisti kreativ. Çajupi është i martuar dhe ka dy fëmijë, të cilët janë inspirimi më i madh i kreativitetit në punë, thjeshtë familja ia plotëson personalitetin.

Andaj mendojmë se kemi nderin dhe privilegjin që natyrën e ndërlikuar të punës policore ta zbukurojmë me vija të mira.

Intervistoi: MERITA CANOLLI - GASHI



NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE (AKSP) VAZHDON TRAJNIMIN GJENERATA E 54-TË E KADETËVE POLICORË

Në Akademinë Policore për Siguri Publike në Vushtrri ka filluar trajnimin gjenerata e 54-të e kadetëve policorë. Programi i trajnimit është i aprovuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Në Akademinë Policore për Siguri Publike në Vushtrri ka filluar trajnimin gjenerata e 54-të e kadetëve policorë. Programi i trajnimit është i aprovuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Kjo gjeneratë numëron 419 pjesëmarrës ku 289 janë meshkuj dhe 130 janë femra, prej tyre janë: 269 shqiptarë, 17 serbë, 1 turk, 1 boshnjak, 1 goran dhe 1 i nacionalitetit egjiptian.

Policia e Kosovës ka për qëllim të përgatisë zyrtarë policorë të arsimuar, që të jenë në gjendje të gjykojnë drejt, të komunikojnë qartë, të marrin vendime, të udhëheqin dhe të përballen suksesshëm me sfidat e së ardhmes.

Për t'u bërë pjesëtar i Policisë së Kosovës fillimisht duhet rrugëtuar në disa procese të rëndësishme dhe esenciale për të vazhduar me hapa të sigurt.

Disa prej tyre janë:

- Testi me shkrim
- Testi i shkathhtësive fizike
- Intervista
- Kontrollimi mjekësor
- Verifikimi i së kaluarës

Pas procedurave fillestare, angazhimin e tyre në akademi ata e filluan në janar të këtij viti dhe gjatë pjesëmarrjes së tyre në këtë trajnim ata do të njoftohen me të



gjitha ecuritë e punës dhe profesionit të një polici.

Trajnimi profesional për policë të rinj ka filluar në shkurt të këtij viti dhe parashihet të përfundojë në shtator 2019.

Gjatë periudhës gjashtëmujore ata do të punojnë me një planprogram me metodologji të avancuar i cili do t'i përgatisë në mënyrë profesionale kadetët që të arrijnë gradën e synuar.

Programi që bëjnë është një prej programeve më të përbushura dhe përmban rregulla të qarta, të përpikta të cilat duhet t'i zotërojë një profesionist.

Duke pasur parasysh mënyrën e aplikimit, programi i trajnimit profesional për policë të rinj zgjat 79 javë.

Ky program përbëhet prej dy pjesëve:

Pjesa teorike e cila zgjat 30.5 javë dhe pjesa praktike e cila zgjat 48 javë.

I gjithë trajnimi përbëhet nga 12 module, prej tyre 8 module janë të obligueshme dhe 4 module janë zgjedhore, ndërsa janë tri module nga pjesa praktike, ku prej moduleve zgjedhore duhet të zgjidhen dy module nga vetë kadetët në mënyrë vullnetare.

Si module zgjedhore konsiderohen kursi për teknologjinë informative, kursi për aftësimin e vozitësve kategoria "B", kursi për mësimin e gjuhës angleze dhe taktikat vetëmbrojtëse.

Secili modul i ka specifikat e veta dhe me këtë rast kadetët përfitojnë njohuri që u ndihmojnë në kompletimin e profesionit që do të marrin.

Pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit dhe kalimit të testeve të parapara për këtë pjesë, parashikohet që kadetët do të fillojnë pjesën praktike që është e paraparë të mbahet në nivelin lokal në stacionet policore dhe vendkalimet kufitare:

- Praktikë mbi çështjet në operativë në stacionin policor
- Praktikë mbi çështjet në hetime në stacionin policor
- Praktikë mbi çështjet në policinë kufitare, vendkalimet kufitare.





Testet mbahen në fund të çdo moduli, ku kadeti duhet të arrijë 70% e më lart ndërsa testi final mbahet pas kryerjes së të gjitha moduleve në fund të trajnimit. Pas përfundimit të të gjitha moduleve teori-praktikë kadetët parashikohet të kthehen në DTTH (Drejtoria e Trajnimit Themelor) në AKSP për një javë për përsëritje të programit, diskutime, vlerësime dhe nënshtrimit për testin final, ku pas kryerjes së testit final certifikohen në ceremoni diplomimi të organizuar nga PK-ja dhe kadeti fiton thirrjen POLIC i RI. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK-së) z. Rashit Qalaj në fillim të trajnimit realizoi një vizitë në AKSP, me ç'rast iu dëshiroi mirëseardhje kadetëve të rinj dhe njëherit i inkurajoi ata që të japin maksimumin e tyre në përfundimin me sukses të trajnimit. Numri i kandidatëve që janë duke vijuar trajnimin në AKSP në mënyrë tabelore:



Etniciteti	M	F	Total
Shqiptarë	269	120	389
Serbë	17	9	26
Turk		1	1
Boshnjak	1		1
Goran	1		1
Egjiptian	1		1
Total	289	130	419

Gjinia	Total	%
Meshkuj	289	68.97%
Femra	130	31.03%
Totali	419	100.00%

Merita CANOLLI- GASHI

PËRPPJEKJET E POLICISË SË KOSOVËS KUNDËR PËRDORIMIT DHE TRAFIKIMIT TË DROGAVE MBETEN INTENSIVE DHE JAPIN REZULTATE

Lufta kundër dukurive negative në vend, posaçërisht parandalimi dhe hetimi i rasteve të trafikimit me narkotikë, ka qenë objektiv i Policisë dhe gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa operacione të suksesshme policore ku kanë rezultuar me konfiskime të konsiderueshme të drogës dhe arrestime të personave të dyshuar të involvuar në këto aktivitete kriminale



Lufta kundër dukurive negative në vend, posaçërisht parandalimi dhe hetimi i rasteve të trafikimit me narkotikë, ka qenë objektiv i Policisë dhe gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa operacione të suksesshme policore ku kanë rezultuar me konfiskime të konsiderueshme të drogës dhe arrestime të personave të dyshuar të involvuar në këto aktivitete kriminale.

Në fillim të këtij viti, Policia e Kosovës (PK), përmes Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, njësiteve relevante të Ferizajt dhe në asistencë të njësiteve për reagim të shpejtë, pas një hetimi disa mujor, ka realizuar një operacion të suksesshëm policor, i cili ka rezultuar me arrestimin e gjashtë (6) personave të dyshuar.

Ky operacion policor është realizuar nën urdhëresën dhe bashkëpunimin e ngushtë

me Prokurorinë Themelore Ferizaj, Departamenti për krime të Rënda, pasi është vazhdimësi e hetimeve që ndërlihet me një operacion policor të realizuar në tetor të vitit 2018.

Si rezultat i vazhimit të hetimeve intensive në shkurt të vitit 2019, në dy lokacione të Ferizajt është realizuar kontroll policor, i cili ka rezultuar me arrestimin e personave të dyshuar, nën dyshimin e bazuar se kanë vepruar si grup kriminal të përfshirë në veprën penale 'blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge'.

Gjatë këtij operacioni policor është konfiskuar një sasi e konsiderueshme e substancave narkotike e llojit marihuanë, e mbështjellë në 193 paketime, e cila pas matjes ka rezultuar të jetë 209.202 kg.

Gjatë këtij operacioni policor janë arrestuar 6 (gjashtë) persona të dyshuar.

Në këto lokacione përveç konfiskimit të substancës narkotike, në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe janë konfiskuar edhe katër vetura (pasat, Venta, Golf IV dhe Sharan, para kesh 839 euro e 95 cent, para kesh 520 denarë maqedonas, para kesh 3 dollarë amerikan dhe gjashtë telefona celularë.

Referuar operacionit të parë policor të realizuar në tetor të vitit 2018, ku ishin konfiskuar 108 kilogramë e 13.3 gramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanë, si dhe tani rastit të lartpërmendur ku janë konfiskuar 193 paketime, në sasi prej 209.202 kg, totali rezulton të jetë rreth 317 kilogramë.

UEB FAQJA ZYRTARE E POLICISË SË KOSOVËS WWW.KOSOVOPOLICE.COM

Gjatë vitit 2018 ka pasur ngritje të vizitave (klikimeve) në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës (www.kosovopolice.com), shprehur në përqindje 164.94% më shumë se në vitin 2017

Ueb faqet me një histori relativisht të shkurtër që nga viti 1989, tani janë bërë një burim i përditshëm dhe i gjithanshëm i informacionit dhe shërbimeve të ndryshme për njerëzit që jetojnë anë e mbanë globit. Ueb faqet tani më janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë të përditshme, ku ne përdorim ueb faqe pothuajse për çdo gjë, duke përfshirë këtu: për lajme dhe informacione, menaxhimin e llogarive bankare, rrjete sociale, kujdes shëndetësor, taksa shtetërore, arsim, argëtim, lojëra e të tjera. Përparësia e ueb faqes është se ato janë gjithmonë në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë gjatë tërë vitit, gjë që ishte e pamundur vetëm disa vjet apo një dekadë më parë.

Duke marrë parasysh që ueb faqja është një aset mjaft i rëndësishëm i një organizate në zhvillimin dhe ngritjen e imazhit të saj, ne jemi përkushtuar që zhvillimi dhe ngritja profesionale të pasqyrojë në ngritjen dhe zhvillimin e Policisë së Kosovës në përgjithësi. Gjatë vitit 2018 është krijuar një 'grup punues', i cili grup ka punuar në



Figura 1: Ueb faqja zyrtare e Policisë së Kosovës



Figura 2. Statistikat e vizitave gjatë vitit 2018 në ueb faqen e PK-së

specifikat teknike të zhvillimit të një ueb faqe të re profesionale dhe të sigurt që do t'i plotësojë nevojat dhe të pasqyrojë zhvillimin e Policisë së Kosovës. Gjatë vitit 2018 ka pasur ngritje të vizitave (klikimeve) në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës (www.kosovopolice.com), shprehur në përqindje 164.94% më shumë se në vitin 2017. Numri i vizitave sipas përdoruesve gjatë vitit 2018 ka qenë 355 703 krahasuar me vitin paraprak 2017 që ka pasur 134 260. Kurse nëse bëjmë krahasimin në 'Pageviews' atëherë kjo përqindje është edhe më e lartë 238.76%

më shumë se vitin paraprak, siç mund ta shihni nga grafiku që është nxjerrë nga 'Google Analytics' për ueb faqen e Policisë së Kosovës.

Mund të themi se ndikimi i përdorimit dhe i mediave sociale si Facebook, Youtube dhe Twitter është evident në ndikimin në masivizimin dhe informimin e qytetarëve lidhur me punën dhe aktivitetet e përditshme që bëhen nga Policia e Kosovës .


Mediat sociale (Facebook, Twitter & Youtube)

Faqet e rrjeteve sociale janë komunitete virtuale që mundësojnë qasje në kohë reale, sinkronizim të komunikimit, mundësi të postimit dhe ndarjes së fotove, videove, punës origjinale dhe kreative etj. Tipari kryesor i rrjeteve sociale është aftësia për t'u lidhur me njerëzit dhe për të shkëmbyer informata. Mediat sociale sot kanë hapur opsione të reja për informacionin, duke e bërë komunikimin me publikun dhe jetën më dinamike. Zhvillimi i tyre është një nga sukseset më të mëdha të revolucionit mediatik social, përmes krijimit të rrjeteve të mëdha që ndajnë mes tyre identitete, informacion dhe ide.

Madje shumica e liderëve politikë dhe shumica e institucioneve i shfrytëzojnë rrjetet sociale për shkak të audiencës së lartë që ato kanë. Përveç informimit të publikut në këtë audiencë masive përfitohet edhe reagimi i shpejtë, pa kosto, i përshtypjeve të qytetarëve ndaj shërbimeve të ofruara.

Mediat sociale ofrojnë një pafundësi zgjedhjesh dhe shkëmbim informacioni mbi shërbime dhe produkte të caktuara me konsumatorë.

Duke parë këtë trend të zhvillimit, që prej vitit 2014 edhe Policia e Kosovës ka filluar të jetë prezente në media sociale, siç janë Facebook, Twitter dhe Youtube. Që nga ajo kohë mund të vërehet qartë që ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në publikimet e bëra nga Policia e Kosovës, përkatësisht nga ZIMP, për publikun e gjerë dhe mediat tjera informative. Kjo ka ndikuar edhe në rritjen dhe masivizimin e shikimeve,



vizitave dhe klikimeve në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës ku shihet që ka pasur rritje të klikimeve në vitin 2018 për 164.94 % në krahasim me vitin e kaluar. Numri i pëlqimeve të faqes së Policisë së Kosovës në Facebook ka arritur mbi 53 838 'Like' në fund të 2018 dhe është duke u rritur vazhdimisht.

Në krahasim me faqe të ngjashme të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës të cilën e ofron Facebook-u, faqja e Policisë së Kosovës renditet e para si për nga numri i pëlqimeve që ka po ashtu edhe nga numri i postimeve dhe shikimeve në



Page	Total Page Likes	From Last Week	Posts This Week	Engagement This Week
1 Kosovo Police	54K	▲0.9%	13	4.5K
2 Komisioni Qendror i Zgj...	18.9K	0%	0	0
3 Ministria e Diasporës	18.8K	▼0.1%	0	0
4 Administrata Tatimore e ...	16.7K	▲0.1%	2	92
5 Dogana e Kosovës	14K	▲0.1%	0	0
6 Ministria e Punëve të Br...	13.8K	▲0.2%	7	150

Figura 3: Faqe të ngjashme të institucioneve

Facebook (shih Figura 3). Përveç kësaj, faqja e Policisë së Kosovës në Facebook është e verifikuar (e shenjuar) si faqe zyrtare që përfaqëson një organizatë të rëndësishme, siç është Policia e Kosovës, për dallim prej institucioneve tjera të cilat nuk i kanë verifikuar ende dhe kjo gjë është bërë me angazhim nga stafi ynë në bashkëpunim me DTIK për ta bërë këtë verifikim, gjë që ka përparësi në aspektin e besueshmërisë.

Vlen të ceket se gjatë kësaj periudhe kohore çdo informatë për media dhe publikun që publikohet në ueb faqe zyrtare të Policisë www.kosovopolice.com të shpërndahet edhe në mediat (rrjete) sociale Facebook dhe Twitter si dhe videot në kanalën e Policisë së Kosovës në Youtube. Kjo ka pasur impakt të mirë në publik në përgjithësi si dhe angazhime shtesë për stafin tonë.

Osman OSMANI

INICIATIVA POZITIVE PËR PËRFSHIRJE MË AKTIVE TË GJINISË LIDHUR ME SIGURINË NË SHOQËRI

Drejtoria e Policisë në Bashkësi, respektivisht Sektori për Bashkëpunim me forumet e sigurisë dhe me mbështetje nga OSBE-ja, në qershor të këtij viti kanë organizuar "Punëtorinë mbi përfshirjen e gjinisë në iniciativat lidhur me sigurinë në komunitet"

Drejtoria e Policisë në Bashkësi, respektivisht Sektori për Bashkëpunim me forumet e sigurisë dhe me mbështetje nga OSBE-ja, në qershor të këtij viti kanë organizuar "Punëtorinë mbi përfshirjen e gjinisë në iniciativat lidhur me sigurinë në komunitet".

Në këtë punëtori, që si qëllim kryesor ishte ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimin e rolit të gruas në iniciativat lidhur me sigurinë në komunitet, pjesëmarrës ishin: kolonel Gazmend Hoxha, drejtor i Divizionit për Siguri Publike, Policia e Kosovës, z. Kilian Wahl, zëvendësambasador i misionit të OSBE-së në Kosovë, major Vjollca Hoti, ushtrues detyre e kryetares së Shoqatës së Grave Police të Kosovës, znj. Edi Gusia, drejtoreshë ekzekutive, Agjencioni për Barazi Gjinore, znj. Rozafa Ukimeraj, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues nga ICITAP-i Ambasada Amerikane në Prishtinë, Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Pas diskutimeve të rëndësishme nga akterë relevantë në këtë punëtori dolën edhe disa rekomandime: të punohet në përfaqësim të njëjtë gjinor dhe të drejta të barabarta, të respektohet në kuota jo vetëm përfaqësimi gjinor, por edhe ai i komuniteteve dhe përkatësive etnike, perspektiva gjinore medoemos duhet bazuar në kualitet, e jo vetëm në kuantitet, edhe pse kuadrot dhe mekanizmat ligjorë e institucionale janë të rregulluara në vend, duhet më tepër të përqendrohemi në zbatimin/ implementimin e tyre dhe të kërkohet llogaridhënie për çdo moszbatim dhe shkelje, fuqizimi ekonomik e sidomos i shtresave më të ndjeshme, përfshirë dhe



të punohet në përfaqësim të njëjtë gjinor dhe të drejta të barabarta, të respektohet në kuota jo vetëm përfaqësimi gjinor, por edhe ai i komuniteteve dhe përkatësive etnike

gratë, duke nënvizuar çështjen e pronës dhe të drejtat e grave, sidomos në rastet e dhunës në familje.

Po ashtu u inkurajua që të punohet më tepër në edukimin dhe arsimimin e të gjithëve pa dallim, luftimin e përbashkët të dukurive negative në përgjithësi dhe në veçanti në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e përfshirjes gjinore në të gjitha sferat e zhvillimit demokratik, e sidomos kur kemi të bëjmë me sistemet tranzitore, të vazhdohet me ligjërata vetëdijesuese në shkolla nga ana e Policisë së Kosovës dhe të merret parasysh kërkesa për inkorporime të psikologëve dhe pedagogëve në sistemet shkollore.

Rekomandimet tjera përfshijnë harmonizimin e kulturave dhe mentalitetit të të gjitha komuniteteve konform obligimeve, për të respektuar dhe për të zbatuar ligjet në fuqi, rritja e pjesëmarrjes së grave në të gjitha institucionet publike

dhe pozitat vendimmarrëse/menaxheriale, organizimi i diskutimeve publike dhe ngritja e zërit për përfshirjen e grave në nismat e sigurisë në bashkësi, vazhdimi me përkrahje të projekteve të forumeve të sigurisë për mirëqenie më të mirë për të gjithë.

Akterët po ashtu u zotuan të jenë aktivë dhe koshientë në luftimin e përbashkët të dukurive negative me të gjithë mekanizmat në veprim, revitalizimi i forumeve të sigurisë dhe trajnime për ngritje të kapaciteteve sipas kërkesave dhe nevojave, plasimi mediatik për aktivitetet e forumeve të sigurisë dhe nismave të sigurisë në bashkësi, si dhe të vazhdohet me iniciativat më të shpeshta nga ana e Policisë së Kosovës për Policimin në Bashkësi dhe Siguri në Bashkësi.

Begishe KRASNIQI



NJËSIA PËR SIGURIMIN E OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE FETARE

Gjatë punës së deritashme, njësia ka arritur të zhvillojë vazhdimisht kapacitete, bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësive fetare, institucionet e Qeverisë së RKS, institucionet ndërkombëtare dhe shumë organizata të tjera.

Njësia për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore Fetare (NjSOTKF/ JOOKVN) funksionon më shumë se 6 vjet në kuadër të Drejtorisë për Sigurimin e Objekteve të Rëndësishme të Veçantë dhe Personaliteteve (DSORVP) në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë.

Pas formimit kjo njësi është marrë me sigurimin e 23 objekteve të trashëgimisë kulturore fetare (OTKF) në RKS, ku po ashtu nga KFOR-i kemi marrë sigurimin e "Patriarkanës së Pejës" dhe deri në ditë e sotme sigurojmë këto objekte (OKVN/ OTKF SPC) në tërë territorin e RKS 24/7 (24 orë në ditë pandërprerë).

Gjatë punës së deritashme, njësia ka arritur të zhvillojë vazhdimisht kapacitete, bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësive fetare, institucionet e Qeverisë

së RKS, institucionet ndërkombëtare dhe shumë organizata të tjera.

Sigurimi i OTKF (objekteve të trashëgimisë kulturore fetare) është ngritur në një nivel më të lartë, vizitat nëpër këto objekte janë intensifikuar, janë siguruar numër i madh manifestimesh ku kishte edhe shumë vizitorë VIP dhe se nuk është raportuar ndonjë incident serioz. Sigurimi i manifestimit "Vidovdan" në Gazimestan dhe Graçanicë, ku kjo njësi ka një nga rolet më të rëndësishme dhe deri më tani të gjitha detyrat janë kryer në mënyrë profesionale. Krahasuar me kohët e mëparshme, gjendja e sigurisë rreth ndërtesave fetare është përmirësuar shumë, ku në vitin që po lëmë pas (2018), asnjë rast nuk është shënuar ose raportuar në objektet e siguruar nga NjSOTKF. Janë përpiluar plane për reagime në situata të ndryshme,

duke koordinuar aktivitetet me Drejtoritë Rajonale të Policisë dhe stacione përkatëse policore.

Njësia është e një karakteri multietnik në të cilin janë të angazhuar mbi 200 zyrtarë policorë, rreth 30% të komuniteteve etnike jo shumicë në RKS (K-serbë, K-boshnjakë, K-turq e të tjerë). Bashkëpunimi në mes të zyrtarëve policorë, mbështetja dhe përkushtimi është në nivel të lartë. Është interesante të theksohet se një numër i madh zyrtarësh policorë nga të gjitha etnitetet kërkojnë që të jenë pjesë e kësaj njësie, gjë që është një tregues pozitiv për nivelin profesional të menaxhimit të kësaj njësie, përdorja e raporteve nga burime të ndryshme konfirmojnë dedikimin dhe kapacitetet e ngritura të Policisë së Kosovës për mbrojtje të këtyre objekteve.

FUSHATA HUMANITARE “DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT”

Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, edhe këtë vit kanë realizuar fushatën vetëdijesuese humanitare “Dhurimi vullnetar i gjakut”. Kjo fushatë organizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore (DPP) dhe ka për qëllim shprehjen e solidarizimit mes njerëzve dhe nevojave të tyre



Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, edhe këtë vit kanë realizuar fushatën vetëdijesuese humanitare "Dhurimi vullnetar i gjakut". Kjo fushatë organizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore (DPP) dhe ka

për qëllim shprehjen e solidarizimit mes njerëzve dhe nevojave të tyre.

Me gjithë natyrën e rëndë të punës së zyrtarëve policorë, të cilët çdo ditë ballafaqohen me sfida të rënda të jetës, ata shprehën gatishmëri të lartë për të dhuruar doza gjaku, në shërbim të nevojave të

kolegëve të tjerë si dhe për raste tjera ku paraqitet nevoja.

Kësaj fushate humanitare iu përgjigjën një numër i madh i dhuruesve vullnetarë (përfshirë stafin e uniformuar dhe stafin civil), duke shpalosur kështu humanitetin e tyre në shërbim të qytetarëve të Kosovës.



Kadetët policorë të gjeneratës së fundit, të cilët janë duke vijuar trajnimin në AKSP, iu përgjigjën me një entuziazëm të lartë dhurimit vullnetar të gjakut. Kësaj fushate i kontribuuan edhe pjesëtarët e Njësiwe Speciale të PK-së në kampin ‘Vrella’ dhe në kampin ‘Belvedere’.

Në kampin ‘Vrella’ çdo vit ka numër të madh të dhuruesve, ku organizimi bëhet me dinjitet dhe sensibilizim paraprak.

Për të prezantuar këtë aktivitet këtë fushatë e kanë ndjekur edhe mediat, duke bërë që aktiviteti të shfaqet në opinion me vlerat dhe rezultatet që ka arritur t’i ketë.

Personeli i Policisë, përfshirë edhe kadetët policorë, vullnetarisht i janë përgjigjur fushatës së lartpërmendur, me një motivim të lartë dhe vullnet të jashtëzakonshëm.

Numri i dhuruesve vullnetarë të gjakut ka arritur shifrën 713, ku ky numër i përgjithshëm u arrit pas 32 aksioneve në kuadër të kësaj fushate. Për dallim nga vitet e tjera numri i dhuruesve është rritur (176 dhurues më shumë).

Drejtorja e Shërbimeve Shëndetësore e Policisë së Kosovës u është falënderuese për zemërsisht të gjithë dhuruesve vullnetarë të gjakut të të gjitha Drejtorive Rajonale të PK-së, stacioneve policore, aeroportit, kadetëve policorë në AKSP dhe

personelit policor aty dhe pjesëtarëve të DNJS-së.

Drejtorja e Shërbimeve Shëndetësore e Policisë së Kosovës (DSHS) mban bashkëpunim të shkëlqyer me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)

Dhe me rastin e përmbylljes së fushatës humanitare "Dhurimi vullnetar i gjakut në PK, drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, Dr. Bukurie Zhubi (Transfuziologe) ka ndarë mirënjohje për kreun e Policisë z. Rashit Qalaj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, si dhe për përkrahësit e tjerë që kanë ofruar mbështetje për realizimin e fushatës së lartpërmendur.

Me këtë rast drejtori i Përgjithshëm z. Rashit Qalaj ka pritur në zyrë ekipin e QKTGJ-së, ku ndër të tjera iu premtoi vazhdimin e bashkëpunimit reciprok dhe të dy palët vlerësuan lart aktivitetin "DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT" të organizuar nga DSHS/DPP.

Përgatiti:
Dr. Lindita Kajtazi
Enterniste-endokrinologe



KURIOZITETE



A e dini se...

1. Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara, privimi i njerëzve nga lidhja me internetin konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut
2. Anuptaphobia quhet frika e të ndenjrit të vetmuar për gjithë jetën
3. Filozofi grek, Chrysippus, ka vdekur nga e qeshura. Pasi urdhëroi një skllav t'i jepte gomarit të pinte verë, ky i fundit filloi të përpiqej që të hante fiq
4. Nëse qëndroni pa gjumë, ditën e nesërme do të keni më shumë dëshirë për të ngrënë
5. Mesatarisht çdo njeri ka 3000 mendime në ditë
6. 85% e personave i marrin vendimet e tyre më të rëndësishme ndërsa janë në dush.
7. Transporti i grave në krahë është një sport, kampionati botëror i të cilit zhvillohet në Finlandë. Çifti që fiton merr si shpërblim një sasi birrë të barabartë me peshën e gruas së tij (që ka mbajtur në krahë)
8. 48% e gjithë popullsisë botërore nuk e ka provuar asnjëherë ndonjë pije alkooolike
9. Në gojën e çdo njeriu ka më shumë baktere se sa janë njerëz mbi tokë
10. 90% e njerëzve i referohen Google Search për të parë nëse e kanë formuluar saktë një fjalë.

Zbulohen gjenet për një jetë më të gjatë

Studiuesit në Qendrën Mjekësore Universitare (UMC) në Amsterdam kanë zbuluar një ndryshim të rrallë gjenetik që redukton shumë gjasat e sëmundjes Alzheimer dhe dy forma të tjera të demencës.

Përveç kësaj, është e mundshme që ky gjen rrit mundësinë për një jetë më të gjatë, shkruan revista shkencore Acta Neuropathologica.

Sipas informacionit të botuar në artikull, ky zbulim jashtëzakonisht i rëndësishëm sjell mundësi të reja në zhvillimin e ilaçeve për sëmundjen Alzheimer, por edhe forma të tjera të demencës që nuk mund të trajtohen në këtë moment.

Shkencëtarët presin që zbulimi i këtij gjeni përgjegjës për rregullimin e sistemit të trurit do të çojë në një hap më afër shërimit të sëmundjes Alzheimer.

Hulumtimi i udhëhequr nga gjenetisti klinik Hene Holstehe në UMC në Amsterdam është kryer mbi gjashtëmbëdhjetë grupe të ndryshme të popullsisë në 60 institutet kërkimore në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore.

Gjeni Rs 72824905 duket se ka një rol mbrojtës në prodhimin e proteinave te pacientët që kanë probleme të memories. Kjo është arsyeja pse shkencëtarët besojnë se duke zbuluar mënyrën se si funksionon ky gjen, do të jetë shumë më afër shërimit të Alzheimerit.

Në format e demencës që përfshiu studimi, qelizat e trurit vdesin për shkak të prodhimit të proteinave të dëmshme në to.

Edhe pse është e panjohur mënyra se si vjen deri te kjo, shkencëtarët besojnë se kjo ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga fakti se sistemi për pastrimin e trurit nga mbeturinat funksionon më keq gjatë viteve.



Semaforët e së ardhmes? Ata do ta kuptojnë automatikisht se kur doni të kaloni rrugën!

Një sistem trafiku i semaforëve i cili mund të kuptojë se ju doni të kaloni rrugën dhe të kalojë automatikisht në dritën jeshile, mund të ju kursejë që të mos keni nevojë të shtypni një buton në të ardhmen.

Sipas mediave të huaja, sistemi i ri, i zhvilluar nga studiuesit austriakë për dy vjet, përdor kamerat e montuara në semaforët e këmbësorëve për të zbuluar njerëzit brenda një fushë prej tetë deri pesë metra. Pastaj, siç thuhet tutje, përdor një algoritëm për të përcaktuar nëse dikush dëshiron të kalojë rrugën “brenda sekondave”, bazuar në modelet e lëvizjes globale dhe të dhënat e regjistruara.

Sistemi i ri mund të minimizojë kohën e pakëndshme të pritjes dhe të zvogëlojë numrin e njerëzve që përpiqen të kalojnë në rrugë kur dritat janë të kuqe, sipas studiuesve. “Kjo kërkon një sekondë për të vlerësuar qëllimin – pas dy sekondave vlerësimi bëhet i besueshëm”, citohet të ketë thënë Horst Possegger nga Instituti i Grafikut Kompjuterik dhe Vizionit të TU Graz në Vjenë.

Përveç procesit të kalimit të rrugës më pak frustruese për këmbësorët, sistemi është projektuar për të optimizuar qarkullimin e trafikut, sidomos për shoferët të cilët duhet të ndalen në kalim edhe pse askush nuk po kalon rrugën.



Aeroporti britanik do të përdorë teknologjinë e njohjes së fytyrës, për të shmangur përdorimin e pasaportave



Në aeroportin më të madh britanik, do të instalohen aparatat me teknologjinë e lartë, që bëjnë njohjen e fytyrës, në mënyrë që të eliminohen procedurat e identifikimit me dokumente. Si pjesë e projektit që kushton 50 milionë funte, do të instalohen kabinat në të cilat kalojnë udhëtarët dhe tregojnë edhe pasaportat, apo dokumentet tjera të nevojshme.

Regjistrimi do të ndihmojë pastaj, që çdo fytyrë e skanuar, të përputhet me dokumentin që ka hyrë në

bazën e të dhënave Me rreth 78 milionë pasagjerë që e shfrytëzojnë këtë aeroport në vit, pritet që koha që kalohet brenda, të jetë sa më e shpejtë.

Deri më tani, ky aeroport shfrytëzon aparatet biometrike nëpër dyer, për të regjistruar fytyrat e atyre që arrijnë në shtet, ndërsa tani e tutje do ta përdorë këtë teknologji në të gjitha fazat e kalimit nëpër aeroport. Njëjtë do të veprojë edhe Gatwick, aeroporti i dytë më i madh britanik, që ka nisur procedurat dhe do të shfrytëzojë të njëjtën teknologji, duke filluar nga muaji që vjen. Të gjitha ata që e përdorin aeroportin Heathrow, duhet të tregojnë pasaportën së paku tri herë, para se të nisen.

Pasaporta duke të tregon në sportel apo te bagazhi, te sigurimi dhe para hyrjes në aeroport. Sistemi i teknologjisë që identifikon fytyrën, pritet të jetë shumë më efikas se sa kontrollat e zakonshme.

Info.

Numrat e Stacioneve Policore

Rajoni i Prishtinës

Drejtoria Regionale Prishtinë	038540021
Trafiku Rajonal Prishtinë	038534234
Stacioni Policor Obiliq	038561600
Stacioni Policor Fushë Kosova	038535812
Stacioni Policor Graçanica	038564292
Stacioni Policor Lipjan	038581010
Stacioni Policor Drenas	038/584092
Stacioni Policor Podujevë	038571805
Stacioni Policor Veriu	038249942
Stacioni Policor Jugu	038549924
Stacioni Policor Qendra	038502223
N/Stacioni Policor Orllan	038614972
N/Stacioni Policor Bërnice	038515092
N/Stacioni Policor Magure	038502472
Nenstacioni Policor Janjevë	038567009

Rajoni Peja dhe Gjakova

Drejtoria Regionale Pejë	039 432327
Drejtoria Regionale Gjakovë	038 504504-5510
Stacioni Policor Pejë	039 433273
Trafiku Rajonal Gjakovë	0390 323784
Trafiku Rajonal Pejë	039 432595
Stacioni Policor Gjakovë	0390 322482
Stacioni Policor Istog	039 451374
Stacioni Policor Klinë	039 471199
Stacioni Policor Deçan	0390 361020
Stacioni Policor Rahovec	029 277913
Stacioni Policor Malishevë	038 269007
Nën Stacioni Policor Gorazhdevc	039 467389
Nën Stacioni Policor Junik	0390 370092
Nën Stacioni Policor Vitomiricë	039/442 203
Nën Stacioni Policor Ponashevc	0390 370888

Rajoni i Mitrovicës

Drejtoria Regionale Mitrovicë	028/532 366
Njesia e Trafikut Rajonal Mitrovicë	028 532 628
Stacioni Policor Mitrovicë Jugu	028 532 585
Stacioni Policor Skenderaj	028/582 087
Stacioni Policor Vushtrri	028/572 010
Stacioni Policor ZubinPotok	028 461 042
Stacioni Policor Zveçan	028 665 130
Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri	028 425 170
Nën Stacioni Policor Leposaviq	028/83 424
Nën Stacioni Policor Prilluzhe	028 573 509

Rajoni i Prizrenit

Drejtoria Regionale Prizren	029/244 355
Trafiku Regional Prizren	029/244 655
Stacioni Policor Suharekë	029/271 024
Stacioni Policor Dragash	029/281 017
Nënstacioni Policor Sredskë	038/502 575
Nënstacioni Policor Mushtisht	029/275 105
Nënstacioni Policor Mamushë	029/273 453
Nënstacioni Policor Zhur	029/625 092

Rajoni i Gjilanit

Drejtoria Regionale Gjilan	0280/330 188
Stacioni Policor Gjilan	0280/330 061
Trafiku Regional Gjilan	0280/330 091
Stacioni Policor Novoberda	038/576 092
Stacioni Policor Viti	0280/381 513
Stacioni Policor Kamënica	0280/372 390
Nënstacioni Policor Kllokot	0280/381 094
Nënstacioni Policor Ranillug	038/504504-7878
Nënstacioni Policor Zheger	0280/386 011
Nënstacioni Policor Pozharan	0280/386-269
Nënstacioni Policor Muqijverre	0280/ 320 197

Rajoni i Ferizajit

Drejtoria Regionale Ferizaj	0290/ 322 406
Stacioni Policor Ferizaj	0290/ 327 412
Trafiku Regional Ferizaj	0290/ 321 899
Stacioni Policor Shtërpçë	0290/ 70092
Stacioni Policor Kaçanik	0290/380 834
Stacioni Policor Hani i Elezit	0290/385 015
Stacioni Policor Shtime	0290/389 008

Përgatiti: Çajup KAJTAZI



20 vjet me Policinë e Kosovës

Policia e Kosovës me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm gjatë këtyre ditëve ka marrë pjesë në një aktivitet të rëndësishëm i Organizatës Jo-Qeveritare “CULTURAT”.

Në fokus kanë qenë aktivitetet me nxënës dhe fëmijë për shënimin e përvjetorit të 20, përvjetor jubilar për Policinë e Kosovës.

Ndër aktivitetet e realizuara janë:

Ndërtimi i një mozaiku me

logon e Policisë së Kosovës, flamuri si dhe vepra arti me motive nga Policia e Kosovës. Gjithashtu, nxënësit pjesëmarrës kanë mbjellë rreth 200 lule duke krijuar numrin 20-simbolikë e 20 vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës.

Punimet e lartçekura iu janë dorëzuar zyrtarisht Drejtorit për Operativë z. Afrim Ahmeti, të cilat do të vendosen në objektin e Policisë së Kosovës.



POLICIA E KOSOVËS ME PJESËTARËT E NJËSISË SPECIALE ELITE “FIT”, TASHMË TË NJOHUR SI “NJSI”, EDHE KËTË VIT KANË MARRË PJESË NË GARAT NDËRKOMBËTARE TË NJËSITEVE SPECIALE CROSS FIT-IT (SPARTA 300), QË ORGANIZOHEN NË SHETIN E HUNGARISË



Policia e Kosovës me pjesëtarët e njësisë speciale elite "FIT", tashmë të njohur si "NJSI", edhe këtë vit kanë marrë pjesë në garat ndërkombëtare të njësiveve speciale cross Fit-it (Sparta 300), që organizohen në shtetin e Hungarisë.

Në këtë garë ndërkombëtare marrin pjesë shtete nga Evropa dhe Azia, ku NJSI, duke dëshmuar përgatitjet e larta profesionale dhe fizike, ka arritur që në garat ekipore të renditet e dyta, përderisa në garat individuale ka rezultuar e para.

Policia e Kosovës edhe pse institucioni më i ri krahasuar me policitë tjera, po arrin të triumfojë në shumë gara sportive në arenën ndërkombëtare.

Policia e Kosovës në vazhdimësi do t'i kushtojë rëndësi të gjitha njësiveve të saj, që të vazhdojnë ngritjen dhe avancimin e tyre në mënyrë profesionale, duke përfshirë edhe shkathhtësitë fizike.

